

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaMur® Finish

SUVA FINIRIMI ME BAZË GËLQEREJE DHE PA ÇIMENTO PËR REHABILITIMIN E MUREVE ME LAGËSHTI



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaMur® Finish është shtresë e hollë suvaje, me bazë gëlqere dhe pa çimento për finirimin e suvatimeve transpiruese.

PËRDORIMET

- Për finirimin e suvave prej gëlqereje, çimentoje dhe me bazë gëlqere/çimento
- Për shmangien e ngritjes së lagështisë së mureve të finiruara, të trajtuara më parë me suvatë dehumidifikuese SikaMur® Dry ose SikaMur®-1000 SP

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Me bazë gëlqereje
- Pa çimento
- Transpirim i lartë
- Ndërkapje e mirë mbi nënshtresë
- Punueshmëri e lehtë
- Finirim i lehtë

MIRATIME / STANDARDE

Llaç suvatimi për përdorim të përgjithshëm (GP) në mjedise të jashtme dhe të brendshme sipas EN 998-1:2010, Deklaratë Performance 90119459 dhe mbart markën CE

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Llaç me 1 përbërës dhe bazë gëlqereje, rërë dhe aditivë të posaçëm
Ambalazhi	thes letre 25 kg me veshje të brendshme
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur i bardhë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në vend të thatë në ambalazhin e padëmtuar dhe të mbyllur
Dendësia	1.80–1.9 kg/L
Përmasa maksimale e kokrrizës	Dmax: 0.6 mm

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	> 0.2 MPa dështim llaçi	(EN 1015-12)
Reagimi ndaj zjarrit	Kategoria A	(EN 13501-1) (EN 998-1)
Përshkueshmëria e avujve të ujit	$\mu \leq 15$	(EN 1015-19)
Përçueshmëria termike	0.27 W/mK	(EN 1745:2002 Tabela A.12)

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit

SikaMur® Finish është pjesë e serisë së sistemit rehabilitues Sika® për restaurim muresh me lagështi dhe përdoret në mënyrë ideale në kombinim me:

SikaMur® InjectoCream-100

Shtrese e injektueshme me bazë silani kundër lagështisë për trajtimin e lagështisë në ngjitje horizontale

SikaMur® Dry

Llaç gati për përzjerje manuale për rinovimin e mureve me lagështi

SikaMur®-1000 SP

Llaç gati për përzjerje manuale ose me makineri për rinovimin e mureve me lagështi

SikaMur® Color I ose E

Bojë me ngjyrë dhe bazë gëlqereje për suva tradicionale ose dehumidifikuese, për finirim dhe mbrojtje të SikaMur® Finish

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes

7.5–8.25 litra ujë të pastër për 25 kg

Konsumimi

~1.2 kg pluhuri për 1 mm trashësi për 1 m²

Trashësia e shtresës

2–3 mm

Temperatura e mjedisit

+5 °C min. / +30 °C max.

Temperatura e nënshtresës

+5 °C min./ +30 °C max.

Koha e punueshmërisë

~180 min në +20 °C

Koha e pritjes / mbiveshja

Prisni të paktën 15 ditë përpara aplikimit të SikaMur® Finish mbi SikaMur® Dry ose SikaMur®-1000 SP për të shmangur plasaritjet mbi sipërfaqen përfundimtare.
Boja përfundimtare dekoruese si SikaMur® Color E ose I, mund të aplikohet pas tharjes së mjaftueshme prej ~ 3 javësh në kushte temperature mesatare.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Suvatë e përgatitura me SikaMur® Dry ose SikaMur®-1000 SP duhet të jenë finiruar me dërrasë të drejtë dhe duhet të lagen përpara aplikimit të SikaMur® Finish.

Suvatë ekzistuese duhet të pastrohen me kujdes duke hequr çdo grimcë të lirë apo mbetje shtresash.

PËRZIERJA

Duke përdorur mikser me aks vertikal, përzieni për të paktën 3 min. Duhet shmangur përzjerja e tepruar për të pakësuar bllokimin e ajrit.

Lëreni materialin e përzierë për ~ 10 min. përpara përdorimit, mos përzieni sërish përpara përdorimit.

APLIKIMI

Aplikoni në 2-3 mm trashësi shtrese me anë të teknikës manuale tradicionale. Finironi me dërrasë për nivelim suvaje.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat me ujë përpara se të ngurtësohet llaçi.

KUFIZIME

- Veglat prej hekuri ose plastike nuk duhet të përdoren për finirimin e sipërfaqes pasi mbyllin flluskat e ajrit tek suvaja dhe parandalon transpirimin.
- Mbi strukturat me lagështi në rritje të trajtuara me SikaMur® Dry ose SikaMur®-1000 SP, SikaMur® Finish duhet të lyhet duke përdorur produkte me veprim minimal pengues të avujve (µ të mos kalojë 10) për parandalimin e flluskave dhe shkëputjeve si SikaMur® Color I ose E
- Referohuni tek shërbimi teknik Sika për asistencë të mëtejshme.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaMur® Finish

Prill 2019, Botimi 01.01

020405020020000028

SikaMurFinish-sq-AL-(04-2019)-1-1.pdf